

VENDIM
Nr. 442, datë 20.5.2015

**PËR NGARKIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR REALIZIMIN E
KONKURSTIT TË PROJEKTIMIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E DISA GODINAVE TË
NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË NË QYTETIN E TIRANËS DHE PËR NJË SHITESË
FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT
URBAN, PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministrit të Drejtësisë, ministrit të Zhvillimit Urban dhe ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për kryerjen e procedurës së prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit, për përfitimin e projektit zbatues për rikonstruksionin e disa godinave të një rëndësie të veçantë në qytetin e Tiranës, përkatësisht:

- a) Vila nr. 31, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
- b) Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, në administrim të Ministrisë së Kulturës;
- c) Muzeu Historik Kombëtar, në administrim të Ministrisë së Kulturës;
- ç) Teatri Kombëtar i Operës e Baletit dhe Ansambli Popullor, në administrim të Ministrisë së Kulturës;
- d) Pallati i Brigadave, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
- dh) Gjykata e Lartë, në administrim të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, t’i shtohet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Kulturës, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama